



| | |
|---|--------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr Prot |
| Dep. | Birorot |
| Dep. <u>2-D</u> | Prot No <u>01-391/16</u> |
| Nr. ltau | Date |
| Bruj stancia | Datum |
| Nr. pages <u>02</u> | Date <u>01-02-2016</u> |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4305/15, për zyrtarin e lartë z. Enver Ademi, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes për shkak se zyrtari i lartë ka dhen dorëheqje nga funksioni publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4305/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Enver Ademi, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Enver Ademi, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes.

Është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Zyrtari i lartë z. Enver Ademi, nuk është paraqitur ne zyrat e AKK-së, ndërsa nga Posta e Kosovës jemi njoftuar se të njëjtit nuk kanë arrit të ja dorëzojnë shkresën zyrtare nga AKK-ja për arsye se i njëjti gjendet jashtë vendit.

Pas këtyre veprimeve kemi kontaktuar me piken kontaktuese ne Komunën e Shtimes ku kemi kërkuar informata zyrtare për z.Enver Ademi, se a është duke ushtruar funksionin publik .

Nga Komuna e Shtimes kemi pranuar informatën, se zyrtari i lartë z. Enver Ademi ka dhen dorëheqje nga funksioni i këshilltarit komunal në Komunën e Shtimes dhe i njëjti është zëvendësuar me një këshilltar tjetër.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Enver Ademi, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes, duke dhen dorëheqje nga funksioni publik janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

